



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
Komisioni për Integrimin European

PROCESVERBAL

Tiranë, më 09.07.2018, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Bledar Çuçi – nënkryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i kalendarit të Komisionit për Integrimin European për periudhën 9 korrik - 27 korrik 2018
2. Shqyrtimi i projektligjit “Për një shtesë në ligjin nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar””.
3. Të tjera.

Marrin pjesë:

Bledar Çuçi, Fatmir Velaj, Elisa Spiropali, Musa Ulqini, Ilir Pendavinji, Arben Kamami, Klodiana Spahiu, Sadri Abazi, Eglantina Gjermani, Ilir Beqja

Mungojnë:

Genc Pollo, Aldo Bumçi, Grida Duma, Jorida Tabaku, Vangjel Dule , Viktor Tushaj, Klajda Gjoshaj

Të ftuar:

Enkelelda Kuci Përgjegjëse Sektori

HAPET MBLEDHJA

Bledar Çuçi – Mirëdita të gjithëve!

Meqenëse formohet kuorumi, fillojmë mbledhjen e sotme të Komisionit për Integrimin European.

Pikë të parë të rendit të ditës kemi miratimin e kalendarit të Komisionit për Integrimin European për periudhën 9 korrik - 27 korrik 2018. Më pas kemi shqyrtimin e projektligjit “Për një shtesë në ligjin nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”, si dhe çështje të tjera.

A jeni dakord me axhendën e komisionit? A ka propozime? Nuk ka.

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Faleminderit!

Fillojmë me miratimin e kalendarit të Komisionit për Integrimin European për periudhën 9 korrik - 27 korrik 2018. Kalendarin e keni të gjithë përpara. Kush është dakord me kalendarin? A ka vërejtje? Nuk ka. Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet kalendari i Komisionit të Integritimit European për periudhën 9 korrik - 27 korrik 2018.

Kalojmë në pikën e dytë, pra në shqyrtimin e projektligjit “Për një shtesë në ligjin nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar””.

Të gjithë e kemi përpara relacionin në lidhje me përshtatjen e ligjit më *acquis*-në.

Ju lutem, bëni një përshkrim të shkurtër vetëm për përputhjen me direktivën.

Enkelelda Kuci – Ne sot po prezantojmë projektligjin “Për një shtesë në ligjin nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar””. Në fakt, ligji për TVSH-në është relativisht i ri dhe ka hyrë në fuqi nga janari i vitit 2015. Është një ligj i përputhur pjesërisht me direktivën e Bashkimit European nr. 2006/112 “Për sistemin e përbashkët të tatimit mbi vlerën e shtuar në Evropë”. Propozohet aplikimi i shkallës së reduktuar të tatimit mbi vlerën e shtuar për furnizimin e shërbimit të akomodimit, të restorantit, me përjashtim të pijeve, të ofruara brenda strukturave, në të cilat zhvillohet veprimtaria pritëse, e certifikuar si agroturizëm.

Ligji për TVSH-në ka parashikuar aplikimin e shkallës standarde për të gjitha llojet e furnizimeve, mallrave dhe shërbimeve në shkallën standarde të tatimit mbi vlerën e shtuar 20%.

Ndërkohë, më hyrjen në fuqi të ligjit aplikohet shkalla e reduktuar 6% për furnizimin e shërbimit të akomodimit në strukturat akomoduese, sipas përcaktimit të legjislacionit në fushën e turizmit.

Më pas vijua me strukturat *brandname* dhe me status special 4 dhe 5 vje. Edhe te këto struktura vijoi aplikimi i kësaj mase, pra i shkallës së reduktuar. Ndërkohë, tani po e shtrijmë atë edhe në strukturat që zhvillojnë veprimtari pritëse të certifikuara si agroturizëm.

Aplikimi i shkallës së reduktuar të tatimit mbi vlerën e shtuar mundësohet nga direktiva, nga neni 98 i saj, të cilin e kemi transpozuar në ligjin tonë te neni 49. Në aneksin 3 të kësaj direktive përcaktohen se cilat janë furnizimet e mallrave dhe shërbimeve mbi të cilat mund të aplikohen normat e reduktuara të TVSH-së. Pra, është një listë e specifikuar furnizimesh, mallrash dhe shërbimesh. Ndërkohë, në këtë listë përfshihet edhe pjesa e shërbimit të akomodimit dhe ushqimit, të cilën po e prezantojmë me këtë projektligj, duke e futur si pjesë të masave në kuadër të paketës fiskale lidhur me incentivat në sektorin e agroturizmit.

Faleminderit!

Bledar Çuçi – Faleminderit!

A ka pyetje nga kolegët?

Arben Kamami – A përfshihen qendrat baleare, llixhat?

Enkeleda Kuci – Normalisht, ne i kemi referuar legjislacionit të fushës së turizmit. Në zbatim të ligjit nr. 93/2015 ka dalë së fundi vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 22, datë 18.01.2018, i cili ka parashikuar kriteret mbi të cilat do të certifikohen subjektet që zhvillojnë veprimtari pritëse, si agroturizëm. Pra, janë ato subjekte që do ta zhvillojnë. Ne në legjislacionin tonë nuk kemi bërë dallim. Nëse nga komisioni që do të jetë përgjegjës për certifikimin si subjekt që zhvillon veprimtari pritëse agroturizëm, subjekti do ta marrë këtë status, atëherë do të përfitojë edhe nga lehtësirat fiskale.

(Diskutime pa mikrofon)

Të paktën te ligji i TVSH-së ne u kemi referuar gjithmonë përcaktimeve dhe kategorive në legjislacionin e fushës së turizmit. Duke qenë se përgjegjëse për atë legjislacion është Ministria e Turizmit, ne kemi marrë gjithmonë si referencë...

Deputet – Turizmi apo agroturizmi?

– Në përgjithësi..

Arben Kamami – Ju po flisni për turizmin, ndërkohë që këtu po flitet për agroturizmin... Qendrat baleare bëjnë pjesë tek turizmi shëndetësor. A përfshihen këto, apo jo?

Enkeleda Kuci – Nuk kemi bërë dallim.

Bledar Çuçi – Po, zoti Beqja.

Ilir Beqja – Domethënë, ligji i turizmit krijon hapësirën për të pasur edhe nënsektorë në turizëm dhe e kanë quajtur agroturizëm. Këtë përfitim do kenë vetëm ato subjekte që do ta marrin atë status nga një komision ndërqeveritar, që e ka përcaktuar VKM-ja e janarit, ku ka përfaqësues nga Ministria e Turizmit dhe nga ministri të tjera. I kanë dhënë afat 5-vjeçar...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Me sa e kam lexuar unë VKM-në e janarit, ajo nuk flet për struktura baleare. Aty thuhet që duhet të ketë kaq hektarë që të prodhosh, pra ka disa raporte që lidhen më shumë me fshatin. Nuk përjashton gjë. Këtë mund ta kërkojmë në nëntor, kur të vijë paketa, se edhe kjo e sotmja më 1 janar hyn në fuqi. Në qoftë se ka një angazhim dhe një premtim, kur të vijë paketa në nëntor, merreni në konsideratë.

Enkleda Kuci – Në dijeninë time, në ligjin për turizmin, në klasifikimin e strukturave akomoduese, te neni 45 futen edhe qendrat kurative, që mund të jenë llixhat. Me ndryshimet e bëra tek TVSH-ja me ligjin nr. 71/2017 besoj se akomodimin e kanë të gjitha të përfshirë me shkallë të reduktuar.

Arben Kamami – Jo, e kanë 20%.

Ilir Beqaj – Nuk janë si hotelet e tjera këto?

Arben Kamami – Jo, e kanë 20%.

Enkeleda Kuci – Ne u jemi referuar, për sa kohë që ato janë struktura akomoduese.

Bledar Çuçi – Faleminderit për sqarimin, megjithëse nuk ishte pjesë e objektit të komisionit tonë. Gjithsesi, për sqarime të tjera zoti Kamami mund të shkojë te komisioni përgjegjës, i cili shqyrton aspektet përkatëse.

Falënderoj përfaqësuesen e ministrisë për sqarimin!

A ka pyetje të tjera? Nuk ka. Diskutime? Nuk ka.

Komisioni del më një raport si komision për dhënie mendimi për t'ia dërguar komisionit përgjegjës. Në bazë të përfarimit, që është një nivel i konsideruar i pjesshëm, raporti del me sugjerimin: “Të shtohet shënimi në fund të faqes që lidhet me titullin e projektligjit, si më poshtë: “Ky ligj është përafuar pjesërisht me direktivën e Këshillit 2006/112/KE, datë 28 nëntor 2006 “Mbi sistemin e përbashkët të tatimit mbi vlerën e shtuar, nr. CELEX 32006L0112, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, seria L, nr. 347, datë 11.12.2006, faqe 1-118, e ndryshuar”.

Kush është dakord që t'ia dërgojmë këtë raport komisionit përgjegjës? Dakord. Kundër nuk ka. Abstenime nuk ka.

Edhe kjo pikë e axhendës u ezaurua. A ka diskutime të tjera? Nuk ka.

Faleminderit për pjesëmarrjen!

Mbledhjen tjetër do ta njoftojmë nëpërmjet sekretarisë.

MBYLLET MBLEDHJA